



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Pimljen/Prodato Received/Delivery	29.12.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIN/84PK	8562/2022		015



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1034/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1034/2022 të datës 21.11.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1034/2022 e datës 21.11.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.153/2022 i Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i datës 11.10.2022

A r s y e t i m

Ankuesja, me datë 21.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokollit 7263/2022, kundër Vendimit Nr.153/2022 të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i datës 11.10.2022.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.153/2022 të datës 10.10.2022 ka bërë shkelje procedurale, vërtetim të gabuar të gjendjes taktike dhe faktike ndërsa ka shkelur dispozitat e ligjit material pasi që ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 05.10.2022 lidhur me përjashtimin e saj nga procedura e rekrutimit për pozitën "Auditor i Brendshëm" me referencë RN00003484, me arsyetimin e njëjta i ka plotësuar kriteret e konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurë e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këshilli, me datë 13.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli:7263/2022 të regjistruar me numër A.nr.1034/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 21.11.2022; E-mailin e ankueses të datës 21.11.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Konkursin e datës 30.08.2022; E-mailin e datës 21.10.2022 dërguar nga për ankuesen; Vendimin e datës 11.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Ankesën e ankueses të datës 05.10.2022; E-mailin e datës 29.09.2022 dërguar nga për ankuesen; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 28.09.2022; E-mailin e ankueses të datës 18.10.2022 dërguar për E-,mailin e ankueses të datës 26.10.022 dërguar për Shkresën e datës 29.09.2022 për verifikimin paraprak për pozitën Auditor i Përgjithshëm; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2020; Diplomën e ankueses të datës 08.01.2015 me numër:009/2015; Diplomën e ankueses të datës 23.02.2010 me numër:2433; Çertifikatën e datës 07.11.2021; Çertifikatën e datës 30.09.2010; Çertifikatën e datës 12.04.2017; Vendimin e datës 19.10.2010; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 22.11.2021; Vërtetimin e datës 21.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen e datës 13.12.2022 me shkresat e bashkangjitura të lëndës; E-mailin ankueses të datës 21.11.2022 dërguar në Këshill; kërkesën e Njesisë së Burimeve Njerëzore të MKRS-së i datës 30.08.2022; Aplikacionin e ankueses të datës 19.09.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur; Vërtetimin e datës 21.10.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 27.01.2022; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Diplomën e ankueses e datës 08..01.2015 me numër:009/15; Çertifikatën e datës 30.09.2022; Çertifikatën e datës 12.04.2017; Vendimin e datës 19.10.2010; Çertifikatën e datës 07.11.2021; Konfirmimin e maujit maj 2015 lëshuar nga BKT; Letër referencë e muajit mars 2009; Kontratën e punës të datës 12.07.2010; Kontratën e punës të datës 13.07.2011; Diplomën e datës 23.02.2010 me numër:2433; Çertifikatë e datës 06.06.2022; Çertifikatë e datës 17.12.2020; Çertifikatë e datës 06.03.2011; Çertifikatë me numër:2013026; Çertifikatë e datës 15.04.2012; Çertifikatë e datës e datës 30.09.2010; Akt emërimin e ankueses të datës 15.07.2012.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**



Bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshilli ka konstatuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 20.08.2022 shpallur konkursin për lëvizjen brenda kategorisë në pozitën "Auditor i Përgjithshëm", ndërsa kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta kanë qenë: " Të jetët nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; të jetët nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetët vlerësuar të paktën mirë për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit; Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetët vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil, ndërsa ka qenë kandidatë në konkursin e datës 30.08.2022 për lëvizjen brenda kategorisë në pozitën "Auditor i Përgjithshëm" të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, mirëpo në fazën e verifikimit paraprak Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 29.09.2022 përmes Vendimin më numër protokoli:4437/2022 ia ka refuzuar ankuesen aplikacionin me arsyetimin se e njëjta nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit ndërlidhur me përvojën profesionale.

Ankuesja kundër Vendimin më numër protokoli:4437/2022 të datës 29.09.2022 ka parashtruar ankesë të brendshme me datë 05.10.2022 në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, ndërsa Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 11.10.2022 kanë nxjerrë Vendimin më numër:153/2022 përmes të cilit e kanë refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar ndërsa kanë theksuar faktin se ankuesja nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme sipas shpalljes së konkursit, me theks të veçantë se ankuesja nuk e ka plotësuar kriterin sa i përket vlerësimeve për dy (2) vite si dhe mungesës së dëshmisë se e njëjta nuk ka masë disiplinore në fuqi, duke lënë të nënkuptojë se refuzimi i aplikacionit nuk i është bërë për shkak të përvojës së punës.

Kolegji i Këshillit nga shkresat e pranuar nga institucioni i cili e ka shpallur konkursin dhe madje as nga vetë ankuesja nuk ka pranuar shkresat apo prova materiale mbi bazën e të cilave ankuesja mund ta ketë dëshmuar se me rastin e aplikimit në konkursin për pozitën "Auditor i Përgjithshëm" të datës 30.08.2022 të ketë arritur të përgatisë të gjithë dokumentacionin e kërkuara, rrjedhimisht nga provat gjegjëse është konstatuar fakti se ankueses i ka munguar formuluar i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 (vitin e fundit) dhe po ashtu e njëjta nuk arritur të dëshmojë me asnjë provë se në kohën e aplikimit nuk ka pasur të shqiptuar ndonjë masë disiplinore aktive në institucionin ku është duke punuar, pra në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, gjegjësisht Njësia e Pranimit me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën ën Shërbimin Civil të Kosovës nenin 43 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.4, dhe 3.5 ku përcaktohet se: "Shpallja për konkurrimit bëhet nga NJBNJ dhe përmban të paktën këto të dhëna: 3.3. kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire që duhet të plotësojnë kandidatët; 3.4. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre; 3.5. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të

përcaktuar me datë të saktë kalendarike" si dhe nenin 45 paragrafi 1 dhe 5 i së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *'1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 5.Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin....'*, pasi që me rastin e shpalljes së konkursit të datës 30.08.2022 ka qenë e përcaktuar data e hapjes dhe dorëzimit të aplikacioneve respektivisht nga data 14.09.2022 deri me datë 21.09.2022, si dhe në pikën 5 të konkursit ka qenë e përcaktuar në mënyrë taksative Dokumentacioni që duhet bashkangjitur: *"kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit si dhe dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende"*, ndërsa siç u theksua edhe më lartë ankuesja nuk ka kompletuar aplikacionin me dokumentacionin e nevojshëm sipas kriterëve të përcaktuara ligjore në konkursin e shpallur të datës 30.08.2022. Ashtu, sikurse Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ka ofruar në cilësi të provës, Vërtetimin që dëshmon se e njëjta nuk ka masë të shqiptuar disiplinore në institucionin ku punon, mirëpo dëshmia është lëshuar me datë 21.10.2022 (pas kalimit të fazë së verifikimit dhe paraqitjes së aplikacionit) si dhe formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 dhe të njëjtave prova nuk u është dhënë rendësi nga Kolegji i Këshillit pasi që të njëjtat dëshmi është dashur të paraqiten me rastin e aplikimit brenda afateve kohore të përcaktuara në konkursin e datës 30.08.2022 në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Nga se u tha më lartë, Kolegji i Këshillit bazuar në konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, analizimit të shkresave të lëndës dhe kushteve të përcaktuara të konkursit të datës 30.08.2022 ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, ndërsa Vendimin më numër:153/2022 të datës 11.10.2022 nxjerrë nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore është vendim i ligjshëm dhe i drejtë pasi që është mbështetur në dispozitat e ligjit material si dhe dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës që përcaktojnë kushtet e nevojshme lidhur me zhvillimin e procedurave të rekrutimit dhe përmbushjes së tyre në mënyrë specifike nga kandidati aplikues.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1034/2022

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAJKTARI

Kryetari i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
- Arkivit të KPMSHCK-së.